



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 28 shkurt 2025

Njoftim për shtyp

Zhvillime më të rëndësishme te institucionet tjera financiare¹ (ITJ): tremujori i katërt i vitit 2024

- **Në tremujorin e katërt të vitit 2024, totali i mjeteve të institucioneve tjera financiare (ITJ) arritën në 255,271 milionë denarë, që paraqet rritje tremujore prej 12,464 milionë denarë.** Institucionet tjera financiare marrin pjesë me 21,2% në mjetet e institucioneve financiare². Në kuadër të strukturës së ITJ-së, fondet pensionale kanë pjesëmarrje më të madhe prej 65,5% në mjetet totale të ITJ-së dhe pas tyre vijojnë kompanitë sigurimeve me pjesëmarrje prej 14,6%.
- **Totali i mjeteve të institucioneve tjera financiare (ITJ), në tremujorin e katërt të vitit, shënoi rritje tremujore me 5,1%, kryesisht në ndikim të rritjes së mjeteve të fondeve pensionale.** Kontribut shtesë pozitiv në rritjen tremujore kanë pasur mjetet e fondeve të investimeve, derisa nënsektorët tjerë kanë një ndikim më të vogël pozitiv, me përjashtim të kompanive të sigurimit, të cilat kanë shënuar rënie të mjeteve. Rritja vjetore prej 21,0% kryesisht vjen si pasojë e rritjes së mjeteve të fondeve pensionale, me një kontribut më të vogël edhe te nënsektorët tjerë, që është më e shprehur te fondet e investimeve.

Tabela 1. Totali i mjeteve / detyrime të ITJ-së, sipas nënsektorëve

	T4.2023	T3.2024	T4.2024	ndryshime tremujore		ndryshime vjetore		Struktura (Totali i IF)	Struktura (Totali i ITF)
				T4. 2024/T3. 2024		T4. 2024/T4. 2023			
	gjendja, në milionë denarë			në milionë denarë	në %	në milionë denarë	në %	në %	në %
1. Institucionet financiare (ITD dhe ITF)	1,077,566	1,128,606	1,205,223	76,618	6.8	127,657	11.8	100.0	0
2. Institucione të tjera depozituese (ITD)	866,538	885,799	949,952	64,154	7.2	83,414	9.6	78.8	0
3. Institucionet të tjera financiare (ITF)	211,028	242,807	255,271	12,464	5.1	44,243	21.0	21.2	100.0
3.1 Fondet pensionale	138,867	159,240	167,312	8,072	5.1	28,445	20.5	13.9	65.5
3.2 Shogëritë të sigurimeve	34,449	37,750	37,291	-459	-1.2	2,842	8.2	3.1	14.6
3.3 Fondet e investimeve	13,499	17,967	21,673	3,706	20.6	8,174	60.6	1.8	8.5
3.4 Shogëritë financiare	11,191	12,284	12,612	327	2.7	1,420	12.7	1.0	4.9
3.5 Shogëritë të lizingut financiar	10,559	12,958	13,638	680	5.2	3,079	29.2	1.1	5.3
3.6 Shogëri administruese të fondeve pensionale dhe investuese	2.463	2.607	2.746	139	5.3	283	11.5	0.2	1.1

Burimi: BPRMV-ja.

¹Në institucione tjera financiare janë të përfshira: fondet e investimit, fondet pensionale, kompanitë e sigurimeve, kompanitë për menaxhimin me fondet investuese dhe kompanitë për menaxhim me fondet pensionale, kompanitë financiare dhe kompanitë ofrues të lizingut financiar.

²Për nevojat e këtij njoftimi në kategorinë e institucioneve financiare (IF) janë përfshirë: institucionet tjera depozitare (ITD - bankat dhe kursimoret) dhe institucione tjera financiare (ITF).



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- **Pjesa më e madhe e fondeve të ITJ-së** janë investime në letrat me vlerë të borxhit dhe kapitalit³ (pjesëmarrje prej 51,9% dhe 26,3%, përkatësisht), **ndërsa në anën e detyrimeve** kryesisht, pjesa më e madhe i referohet rezervave teknike të sigurimit⁴ dhe llogarive kapitale (pjesëmarrje prej 53,1% dhe 37,8%, përkatësisht⁵).

Tabela 2. Mjete / detyrime të ITJ-së, sipas nënsektorëve dhe sipas instrumenteve financiare, tremujori i katërt 2024

	Totali i ITF		Fondet pensionale		Shoqëritë të sigurimeve		Fondet e investimeve		Shoqëritë financiare		Shoqëritë të lizingut financiar		Shoqëri administruese të fondeve pensionale dhe investuese	
	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)	gjendja, në milionë denarë	pjesëmarrja (në %)
TOTALI I MJETEVE	255,271	-	167,312	-	37,291	-	21,673	-	12,612	-	13,638	-	2,746	-
I. Valuta dhe depozitat	18,793	7.4	3,037	1.8	7,325	19.6	6,806	31.4	631	5.0	456	3.3	539	19.6
II. Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	132,525	51.9	110,078	65.8	15,960	42.8	4,783	22.1	72	0.6	-	-	1,632	59.4
III. Kreditë	21,163	8.3	-	-	207	0.6	-	-	10,623	84.2	10,315	75.6	18	0.7
IV. Aksionet dhe kapitali tjetër	67,014	26.3	52,793	31.6	3,914	10.5	10,081	46.5	26	0.2	-	-	200	7.3
V. Rezervat teknike të sigurimit	2,234	0.9	-	-	2,234	6.0	-	-	-	-	-	-	-	-
VI. Derivatëve financiare	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
VII. Kërkesa tjera	8,664	3.4	1,404	0.8	5,836	15.6	4	0.0	871	6.9	398	2.9	150	5.5
VIII. Mjetet jo-financiare	4,879	1.9	-	-	1,815	4.9	-	-	388	3.1	2,469	18.1	207	7.5
TOTALI I DETYRIMEVE	255,271	-	167,312	-	37,291	-	21,673	-	12,612	-	13,638	-	2,746	-
I. Kreditë	16,081	6.3	-	-	97	0.3	-	-	4,900	38.9	11,041	81.0	43	1.6
II. Rezervat teknike të sigurimit	135,455	53.1	111,782	66.8	23,673	63.5	-	-	-	-	-	-	-	-
III. Derivatëve financiare	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
IV. Kërkesa tjera	7,308	2.9	93	0.1	3,053	8.2	78	0.4	2,693	21.4	1,243	9.1	148	5.4
V. Llogaritë kapitale	96,428	37.8	55,437	33.1	10,468	28.1	21,595	99.6	5,018	39.8	1,354	9.9	2,555	93.0

Burimi: BPRMV-ja.

- **Analizuar pas instrumenteve, në anën e mjeteve**, rritja në bazë tremujore dhe vjetore kryesisht është reflektim i rritjes së investimeve në letrat me vlerë të borxhit dhe kapitalit dhe në një masë më të vogël nga valutat dhe depozitat dhe kërkesat të bazuara në kredi. **Nga ana e detyrimeve**, ndryshimi në të dyja bazat i detyrohet kryesisht rritjes së llogarive kapitale dhe rezervave teknike të sigurimeve.


³Letrat me vlerë të borxhit (LVB) i referohen letrave me vlerë të ndryshme nga aksionet në pajtim me klasifikimin ndërkombëtar të instrumenteve financiare, siç është publikuar në bilancet dhe pasqyrat e institucioneve tjera financiare.

⁴Rezervat teknike të sigurimit përmbajnë: kapitalin neto të amvisërive në rezervat nga sigurimi i jetës, kapitali neto i amvisërive në fondet pensionale dhe premitë e parapaguara dhe rezervat kundrejt kërkesës për llogarimbajtje (sigurimi jojetë).


⁵Llogaritë kapitale i përfshijnë: investimet pronësore, fitimi i mbajtur, fitimi nga viti aktual, rezerva e përgjithshme dhe e veçantë dhe përshtatjet me vlerë.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë




Burimi: BPRMV-ja.



Zhvillime më të rëndësishme të ITJ, sipas llojeve të institucioneve

- Në tremujorin e katërt të vitit 2024, norma tremujore dhe vjetore e rritjes së **totalit të mjeteve të fondeve pensionale⁶ (të detyrueshme dhe vullnetare)** shënojnë 5,1% dhe 20,5%, përkatësisht. Ndryshimi në rritje në të dyja bazat vjen si pasojë e rritjes së investimeve në letrat me vlerë të borxhit dhe kapitalit, me një kontribut pozitiv shtesë nga kërkesat tjera, me përjashtim të valutave dhe depozitave, ku u shënua një rënie e aktiveve. Në anën e detyrimeve, ndryshimi tremujor dhe vjetor plotësisht është rezultat i llogarive kapitale më të larta dhe rezervave teknike të sigurimit.




Burimi: BPRMV-ja.

⁶BPRMV-në aktualisht e njoftojnë të gjitha fondet pensionale që janë të përfshira në regjistrin e Agjencisë për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS), nga të cilat shtatë të detyrueshme dhe katër vullnetare fondet pensionale.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- **Totali i mjeteve të kompanive të sigurimit⁷**, këtë tremujor, realizuan rënie tremujore prej 1,2%, si rezultat i uljes së kërkesave tjera dhe rezervave teknike të sigurimit, në kushte të rritjes së vërejtur te instrumentet tjera. Krahassuar me tremujorin e katërt të vitit të kaluar, mjetet e kompanive të sigurimit u rritën me 8,2%, kryesisht si pasojë e rritjes së investimeve në letrat me vlerë të borxhit dhe kapitalit, me kontribute pozitive shtesë nga komponentët e tjerë. Nga ana e detyrimeve, rënia tremujore vjen kryesisht si pasojë e rënies së detyrimeve të tjera dhe rezervave teknike të sigurimeve, në kushtet e rritjes së llogarive kapitale. Rritja vjetore e detyrimeve është kryesisht rezultat i rritjes së rezervave teknike të sigurimit dhe në një masë më të vogël të llogarive kapitale.



Burimi: BPRMV-ja.


- Në tremujorin e katërt të vitit, **totali i mjeteve të fondeve të investimit⁸**, shënojnë rritje tremujore dhe vjetore prej 20,6% dhe 60,6%, respektivisht, kryesisht shkaku i valutave dhe depozitave më të larta dhe investimeve në letra me vlerë të kapitalit dhe të borxhit. Nga ana e detyrimeve, rritja në nivel tremujor dhe vjetor është reflektim i llogarive të rritura kapitale.

⁷BPRMV-në rregullisht e njoftojnë të gjitha gjashtëmbëdhjetë kompanitë e sigurimit që janë të përfshira në regjistrin e Agjencisë për Mbikëqyrje të Sigurimit (AMS), nga të cilat njëmbëdhjetë për sigurim jojetë dhe pesë për sigurim të jetës.

⁸Në regjistrin e Komisionit të Letrave me Vlerë (KLV) aktualisht janë përfshirë njëzet e tre fonde investuese të hapura dhe një fond investues privat, me ç'rast në të dhënat janë përfshirë njëzet e katër fonde investuese.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë



Burimi: BPRMV-ja.

- Në tremujorin e katërt të vitit 2024, **totali i mjeteve të shoqërive financiare**^{9,10} shënoi rritje tremujore dhe vjetore prej 2,7% dhe 12,7%, përkatësisht. Pjesa më e madhe e mjeteve të këtij nënsektori ka të bëjë me kërkesat e bazuara në kredi, të cilat në fund të dhjetorit ishin 10,623 milionë denarë. Norma tremujore dhe vjetore e rritjes së aktivitetit kreditor të shoqërive financiare është 0,8% dhe 8,9%, përkatësisht. Kontribut shtesë në rritjen e mjeteve në të dyja bazat kanë kërkesat e tjera dhe në baza tremujore investimet në letrat me vlerë të borxhit. Nga ana e detyrimeve, ndryshimi tremujor vjen tërësisht si pasojë e rritjes së llogarive kapitale, ndërsa ndryshimi vjetor në masë të madhe vjen nga rritja e llogarive kapitale dhe e detyrimeve të bazuara në kredi, me një kontribut shtesë më të vogël nga detyrimet e tjera.



Burimi: BPRMV-ja.


⁹Në të dhënat për Tr.4 2024 janë përfshirë tridhjetë e pesë kompani financiare.

¹⁰Në tremujorin e katërt të vitit 2017 në seritë të dhëna është përfshirë kompani financiare e re (kursimore që regjistrohet në kompani financiare), ndryshimi që ka ndikim në normat vjetore të ndryshimit.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- **Totali i mjeteve të shoqërive ofruese të lizingut financiar¹¹**, këtë tremujor shënojnë rritje tremujore dhe vjetore prej 5,2% dhe 29,2%, përkatësisht. Pjesa më e madhe nga mjetet të këtij nënsektori janë kërkesat në bazë të kredive, në shumë prej 10.315 milionë denarë dhe u rritën në nivel tremujor dhe vjetor prej 4,0% dhe 24,4%, respektivisht. Nga ana e detyrimeve, rritja tremujore rrjedh kryesisht nga detyrimet më të larta të bazuara në kredi dhe në një masë më të vogël nga rritja e llogarive kapitale, me rënie të detyrimeve të tjera. Rritja vjetore është udhëhequr nga rritja e detyrimeve të bazuara në kredi, ku ndikim pozitiv kanë edhe llogaritë kapitale dhe detyrimet e tjera.




Burimi: BPRMV-ja.

- Në tremujorin e katërt të vitit 2024, **totali i mjeteve të shoqërive për menaxhim të fondeve të pensione dhe investimeve** u rrit me 5.3% në bazë tremujore, ndikuar nga rritja e valutave dhe depozitave dhe letrave me vlerë të borxhit, me një kontribut pozitiv shtesë nga komponentët e tjerë, në kushtet e një rënie të lehtë të kërkesave në baza kreditore. Në bazë vjetore, mjetet e këtij nënsektori shënojnë rritje prej 11,5%, kryesisht si pjesë e rezultatit të rritjes së letrave me vlerë të borxhit, valutave dhe depozitave dhe letrave me vlerë kapitale. Nga ana e detyrimeve, rritja në të dy bazat rrjedh tërësisht nga llogaritë më të larta të kapitalit dhe detyrimeve tjera.

¹¹Në të dhënat aktualisht janë përfshirë nëntë kompani ofruese të lizingut financiar.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë



Rishikimi i të dhënave

Të dhëna për zhvillimin të ITJ-ja në këtë njoftim përmbajnë rishikime të dhënave nga tremujori i katër i vitit 2023. Këto rishikime nuk shkaktuan ndryshime të ndjeshme të të dhënave paraprakisht të publikuara dhe kryesisht rrjedhin nga përfshirja më e mirë dhe cilësia e raportimeve.

Informacione shoqëruese

Seri kohore të të dhënave: Të dhëna tremujore për mjetet dhe detyrimet e institucioneve financiare

<https://www.nbrm.mk/ns-newsarticle-bilans-i-pregledi-na-finansiskite-institucii-kvartalni-podatoci-al.nsp>

Shpjegime metodologjike:

<https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia%20monetarna%2007%202021%20al.pdf>

Informacion për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesit:



**Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Drejtoria për Statistikë**

[https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija%20monetarna 07 2021 al.pdf](https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija%20monetarna%2007%202021%20al.pdf)

Publikimet e ardhshme: Kalendari për publikimin e të dhënave

https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendari_i_publicimit_t%C3%AB_t%C3%ABdh%C3%ABnave.pdf

Të dhëna tremujore për mjetet dhe detyrimet e institucioneve financiare: 30 maj 2025 (mesatare referuese me tremujorin e dytë 2025).

Për pyetje të gazetarëve, ju lutemi kontaktoni me personat nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme në lidhje me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 113 (ose 108/110).